



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
MINISTRI

Nr. 4965 Prot.,

Tiranë, më 20.11 2020

URDHËR

Nr. 473, Datë 20.11, 2020

PËR

SHTYRJEN E AFATIT 30 DITOR TË CAKTUAR NË UDHËZIMIN NR. 385, DATË 13.10.2020 “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR MARRJEN E LICENCËS PËR ADMINISTRIMIN KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TË AUTORIT, RIPËRTËRITJEN E SAJ, SI DHE PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR PEZULLIMIN DHE HEQJEN E LICENCËS NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 35/2016, DATË 31.3.2016, “PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E TJERA TË LIDHURA ME TO”

Në zbatim të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenit 156 të ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, Kreut I, Gërma D, pika 4 e Udhëzimit të Ministrit të Kulturës nr. 385, datë 13.10.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, në zbatim të përkufizimit të forcës madhore në vendimin nr 00-2015-2960 (485) të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si dhe në zbatim të VKM nr. 867, datë 11.11.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 511, datë 24.10.2002, të Këshillit të Ministrave, “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, të ndryshuar” dhe akteve të tjera normative të marra për parandalimin e përhapjes të pandemisë Covid-19 të cilat kanë ngadalësuar ndjeshëm funksionimin e administratës në Republikën e Shqipërisë,

URDHËROJ:

1. Shtyrjen me 30 (tridhjetë) ditë kalendarike të afatit për depozitimin e kërkesave dhe plotësimin e plotë të dosjes së aplikimit për licencim parashikuar në Udhëzimin nr. 385, datë 13.10.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” të Ministrit të Kulturës.

2. Ngarkohet Drejtoria për të Drejtën e Autorit për komunikimin dhe zbatimin e këtij Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Elva MARGARITI

